

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË SUBJEKTET E ADMINISTRATËS TATIMORE DHE  
DOGANORE USHTRUAR “MBI VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË DETYRAVE DHE  
MASAVE TË REKOMANDUARA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM” PËR VITIN 2015**

Raporti përfundimtar i auditimit ushtruar në subjektet e administratës tatimore dhe doganore “Mbi verifikimin e zbatimit të masave të rekomanduara në auditimet e evaduara gjatë 9-mujorit të vitit 2015 dhe në 3-mujorin e fundit të vitit 2014” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 186, datë 31.12.2015.

Bazuar në nenet 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresat nr. 1019/25-30, datë 27.01.2016 dhe nr.1019/31-34, datë 28.01.2016, i janë dërguar subjeteve të audituara pjesë nga Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse.

Në 16 subjekte të audituara dhe të evaduara gjatë 9-mujorit të vitit 2015 dhe në 3-mujorin e fundit të vitit 2014, janë rekomanduar nga KLSH gjithsej 376 masa, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 205 prej tyre, ose në masën 54,5 %, pjesërisht 28 masa, ose 7.5 %, janë në proces zbatimi 58 masa, ose 15 % dhe nuk janë zbatuar 87 masa ose 23 %.

Të analizuara sipas llojit të masave të rekomanduara, zbatimi i tyre rezulton:

a-**Masa për përmirësim ligjore**, janë rekomanduar 7 masa, nga të cilat janë zbatuar 6 masa.

b-**Masa organizative**, janë rekomanduar 150 masa, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 91 prej tyre, pjesërisht 17 masa, janë në proces zbatimi 22 masa dhe nuk janë zbatuar 20 masa.

c-**Masa për shpërbllim dëmi**, janë rekomanduar 90 masa, për vlerën 4,234,432,000 lekë, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 40 prej tyre në vlerë 182,448,156 leke, pjesërisht dhe në proces zbatimi janë 36 masa në vlerën 3,842,204,070 lekë dhe nuk janë zbatuar apo pranuar 14 masa në vlerë 209,779,774 lekë.

d-**Masa administrative**, janë rekomanduar për 3 subjekte, 7 masa administrative, nga të cilat janë zbatuar 2 masa, 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 4 masa nuk janë zbatuar.

e-**Masa disiplinore**, janë rekomanduar 122 masa, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 63 prej tyre, janë në proces zbatimi 10 masa dhe nuk janë zbatuar 49 masa.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe rikërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **1. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE**

Mbi auditimin me objekt: “**Auditimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, për vitin 2014**”, zhvilluar në periudhën nga data 03.06.2015 deri më 27.07.2015 dhe finalizuar me Vendimin Nr. 136, datë 30.09.2015 të Kryetarit të KLSH-së. Rekomandimet dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit u përcollën në subjekt me shkresën nr. 510/25, datë 30.09.2015.

-Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nuk është zbatuar brenda afatit të përcaktuar detyrimi ligjor prej 20 ditë mbi hartimin e plan-veprimit dhe kthimin e përgjigjes KLSH për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga DPD, nuk është kryer monitorimi i realizimit të Plan-veprimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 510/25, datë 30.09.2015.

*Sa më sipër, është rikërkuar* që, në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të raportohet *(me shkrim)* pranë

Kontrollit të Lartë të Shtetit **brenda 6 muajve**, duke njoftuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar shkresën nr. 510/25, datë 30.09.2015, protokolluar në DPD me nr. 24278, datë 05.10.2015, mbi auditimin me objekt “Auditimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, për vitin 2014”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, ose të papranuara, si më poshtë:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

Nga 11 masa organizative të rekomanduara, 1 masë rezulton në proces zbatimi, ndërsa 10 masa nuk janë marrë ende në shqyrtim, pra rezultojnë të pa zbatuara.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 18-33 të RPA është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve:*

**A.1.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të analizojë dhe marrë masa për zbatimin detyrave të rekomanduara dhe të parealizuara të lëna në auditimin e mëparshëm si dhe të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e tyre.

*Menjëherë*

**A.2.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të ndjekë zbatimin e rekomandimit deri në realizimin e plotë të tij, për:

- Plotësimin e vendeve vakante.
- Sistemimin e 5 punonjësve sipas vendimeve të gjykatës.
  - Të vijohet më tej për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për 4 punonjës, duke ndjekur procedurën bazuar në urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.
  - Të zbatohet kërkesa nr. 31269, datë 16.12.2015, e depozituar pranë DAP, për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës, për rikthim në punë të një ish-punonjësi.
- Transferimet: Të ndiqen masat dhe procedurat deri në sistemimin e plotë të punonjësve të transferuar, për t'u rikthyer në vendet e mëparshme.
- Konfirmim statusi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në bashkëpunim me DAP, të ndjekë procesin për konfirmimin e statusit të Nëpunësit Civil, në periudhë prove.

*Menjëherë*

**A.3.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa në zbatim të ligjit për respektimin e të drejtave të punonjësve të administratës së saj në lidhje me kohëzgjatjen e kohës së punës. Në rastet e punës përtej orarit dhe në ditët e pushimit punonjësit duhet të paguhen me pagë shtesë në përputhje me kohëzgjatjen mbi orarin e punës, pasi mospagimi i tyre është me pasoja financiare për buxhetin e shtetit në një vlerë prej rreth *35,815,163 lekë* (4,374,000 lekë shpenzime gjyqësore + 31,441,163 lekë paga shtesë) si rezultat i rëndimit të tij me shpenzime gjyqësore të fituara nga punonjësit e administratës doganore.

*Menjëherë*

**A.4.** DPD të dokumentojë vendimet e Grupit të Menaxhimit Strategjik, në zbatim të Manualin për MFK, pika 4.2.9, si dhe të merren masa që të kryhen trajnime të stafit mbi njohjen dhe procesin e implementimit të MFK-së.

*Në vijimësi*

**A.5.** Nga Drejtoria e Kontrollit në Departamentin e Akcizës, si për rastet e evidentuara në tabelën 9.7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të dërguar me shkresën nr. 510/25, datë 30.09.2015 (TVSH-ja e munguar prej 9,232,235 lekë) ashtu si dhe në vijim, kur konstatohet diferenca në sasi të produkteve të pa hedhura për konsum, të njoftojë përveç Degës Doganore përkatëse edhe Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, si dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në mënyrë që të sigurohet edhe mbledhja e TVSH-së.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**A.6.** Sektori i Statistikave në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe të Financës në DPD, të rakordojnë me Ministrinë e Financave përsa i përket klasifikimit të treguesve të të ardhurave dhe shifrave të raportuara. Raportimi për treguesit e realizimit të planit të të ardhurave të bëhet mbi të njëjtat vlerësime dhe klasifikime.

*Në vijimësi*

**A.7.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të rrisë bashkëpunimin me të gjitha strukturat doganore dhe me strukturat e specializuara të shtetit që merren me administrimin dokumentar dhe fizik të aktiviteteve ekonomike-tregtare të vendit, nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve të përbashkëta dhe aplikimit të tyre kryesisht; me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit, me Sistemin Bankar të Nivelit të Dytë, me Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive, si dhe me Zyrat e Përmbarimit Gjyqësor duke përcaktuar saktë dhe detyrimet e ndërsjella për mbledhjen e borxhit doganor.

*Në vijimësi*

**A.9.** Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të ngrihet një grup pune që të vlerësojë efektivitetin e investimit “Rikonstruksioni i pjesshëm i godinës së Degës Doganore, Fier” dhe nëse ky investim nuk vihet në shfrytëzim, të nxirren efektet financiare të dëmit të shkaktuar dhe përgjegjësit të rikuperojnë vlerën e tij.

Gjithashtu të merren masa për riparimin e të gjitha punimeve të konstatuara me mangësi në cilësi, në këte objekt sipas specifikimeve teknike dhe kontratës për punë publike nr. 27497/11, datë 16.12.2014 nga ana e sipërmarrësit të punimeve.

*Brenda datës 31.01.2016*

**A.10.** Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Procedurave në lidhje me lëshimin e autorizimeve të regjimit të përpunimit aktiv dhe lejimit të përkohshëm janë mbajtur gjithsej 112 procesverbale për shkelje të legjislacionit doganor të pa dorëzuara pranë autoritetit doganor për të dalë me vendim administrativ, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 287.1 të Kodit Doganor dhe pikës 2; 3 dhe 4 të Udhëzimit nr. 6, datë 23.07.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave .

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet Drejtorisë së Auditit të marrë masat për eliminimin e këtij fenomeni, duke ndjekur gjithë procedurat e nevojshme për delegimin e procesverbaleve për shkeljet doganore pranë autoriteteve doganore kompetente.

*Menjëherë*

**A.11.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nëpërmjet Drejtorisë së Auditit të marrë masat duke ndjekur gjithë procedurat e nevojshme për auditimin e problematikës lidhur me shpenzimet për karburantin me qëllim nxjerrjen e dëmit të shkaktuar si dhe përgjegjësitë lidhur me personat shkaktarë të dëmit.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR SHPËRBILM DËMI**

Nga 11 masa “Shpërblim dëmi”, të rekomanduara nga KLSH në vlerën 152,405,100 lekë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nuk ka marrë ende në shqyrtim dhe nuk nxjerrë asnjë akt administrativ për zbatimin e tyre, nga të cilat 10 masa rezultojnë të pashqyrtuara dhe të pazbatuara ndërsa 1 masë e shqyrtuar nuk është pranuar.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 18-33 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve:*

**B.1.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej 468,000 lekë nga ish-zv. Drejtor i Përgjithshëm [REDAKTUAR], i cili ka urdhëruar kryerjen e shërbimit me objekt “Kurs online për përmirësimin e gjuhës angleze”, ose nga të gjithë personat përfitues të këtij kursi.

*Menjëherë*

**B.2.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës prej 126,972 lekë nga operatori ekonomik [REDAKTUAR] konstatuar në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i godinës së Degës së Doganës Fier”.

*Menjëherë*

**B.3.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës prej 216,000 lekë nga [REDAKTUAR] në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim të mallit për tenderin me objekt “Blerje Bicikleta”.

*Menjëherë*

**B.4.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës prej 2,605,820 lekë nga [REDAKTUAR] në cilësinë e kryetarit të KVO, në tenderin e zhvilluar me objekt “Riparimi i skanerit Mobil THSCAN me rreze X”.

*Menjëherë*

**B.5.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës prej 1,056,084 lekë nga grupi i punës për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit [REDAKTUAR] në tenderin e zhvilluar me objekt “Mirëmbajtje e pajisjeve të kontrollit, skanera”.

*Menjëherë*

**B.6.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës prej 581,400 lekë nga grupi i punës [REDAKTUAR] për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit, në tenderin e zhvilluar me objekt “Mirëmbajtje e pajisjeve të lëndëve radioaktive”.

*Menjëherë*

**B.7.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Origjinës, të marrë masa për përgatitjen e dokumentacionit dhe refuzimin e trajtimit preferencial për subjektin [REDAKTUAR].

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e

nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën 1,673,373 lekë për 3 subjekte [REDAKTUAR], sipas aneksit nr. 7.1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 510/25, datë 30.09.2015.

*Menjëherë*

**B.8.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 15 raste, në vlerën 5,496,176 lekë nga subjektet sipas aneksit nr. 8.1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 510/25, datë 30.09.2015.

*Brenda datës 31.01.2016*

**B.9.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 3 raste, në vlerën 4,642,951 lekë nga subjektet sipas aneksit nr. 8.2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit dërguar nga KLSH me shkresën nr. 510/25, datë 30.09.2015.

*Brenda datës 31.01.2016*

**B.10.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 14 raste, në vlerën 133,225,875 lekë, ku vetëm në subjektin [REDAKTUAR] në Degën Doganore Berat, u konstatuan shkelje të rënda në shumën 127,356,379 lekë, nga subjektet sipas aneksit nr. 8.3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, dërguar nga KLSH me shkresën nr. 510/25, datë 30.09.2015.

*Brenda datës 31.01.2016*

**B.11.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në bashkëpunim me Autoritetet Doganore Kompetente, si struktura të varësisë, të marrë masa për zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 16 raste, në vlerën 2,200,049 lekë nga subjektet sipas aneksit nr. 10.1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit dërguar nga KLSH me shkresën nr. 510/25, datë 30.09.2015.

*Menjëherë*

## **C. MASA DISIPLINORE**

Nga 8 masa disiplinore të rekomanduara, rezulton se nuk është marrë në shqyrtim dhe nuk është zbatuar asnjë masë.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 18-33 të RPA i është rikëruar zbatimi i rekomandimeve:*

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, *i rikërkojmë* Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave zbatimin e masave disiplinore, duke filluar procedurat për të kaluar në Komisionin

Disiplinor, sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 për shkeljet e konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda dhe shumë të rënda, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013, për **8 nëpunës**:

a. Neni 58 germa “ç”, “*largim nga shërbimi civil*”, për **5 nëpunës**.

b. Neni 58 germa “b”, “*mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj*”, për **3 nëpunës**.

## **2. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE**

Mbi auditimin me objekt: “**Mbi zbatimin e legjislacionit për Rentën Minerare për vitet 2013, 2014**” zhvilluar në periudhën nga data 09.12.2014 deri më 20.02.2015 dhe finalizuar me Vendimin Nr. 53, datë 30.04.2015 të Kryetarit të KLSH-së. Rekomandimet dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit u përcollën në subjekt me shkresën nr. 1101/17, datë 06.05.2015.

-Nga DPD, nuk është zbatuar brenda afatit të përcaktuar detyrimi ligjor prej 20 ditë mbi hartimin e plan-veprimit dhe kthimin e përgjigjes KLSH për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga DPD, nuk është kryer monitorimi i realizimit të Plan-veprimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar shkresën nr. 1101/17, datë 06.05.2015 dhe raportimi në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, të përcaktuar në nenin 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

*Sa më sipër, është rikërkuar* që, në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të raportohet (me shkrim) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

***Menjëherë***

Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Degëve Doganore, i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së, dërguar me shkresën nr. 1101/17, datë 06.05.2015 protokolluar në DPD me nr. 11213, datë 08.05.2015, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e legjislacionit për Rentën Minerare”, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht ose të papranuara, si më poshtë:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

Nga 6 masa organizative të rekomanduara, 1 masë rezulton e zbatuar, 2 masa të zbatuara pjesërisht dhe 3 masa rezultojnë të pa zbatuara.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 33-47 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve:*

**A.1.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Degët Doganore Fier, Vlorë dhe Kakavijë të bëjnë një analizë të plotë për mosrealizimet dhe shkeljet ligjore, të përcaktojë përgjegjësitë dhe masat përkatëse. Për realizimin e të ardhurave nga taksa kombëtare e Rentës Minerare të hartojnë një program pune të detajuar me afate e persona përgjegjës sipas specifikave konkrete të çdo dege doganore dhe llojeve të mineraleve e nënprodukteve të tyre që eksportohen.

***Menjëherë***

**A.2.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mbështetur në çmimet e tregjeve ndërkombëtare, të dhënat statistikore të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, investigimit të tregut brenda dhe jashtë vendit, të bëjë azhurnimin dhe t'jua dërgojë Degëve Doganore të dhënat e disponueshme për çmimin e hekur-nikelit, të dhëna të cilësisë e përmbajtjes së tij.

*Menjëherë*

**A.4.** Praktikrat Doganore të eksportit të shoqërohen me Raport-Analiza, të përmbajtjes së mineralit nga Laboratorë të akredituar, si dhe të mbahet akt rakordimi për të ardhurat nga pagesa e rentës minerare me Njësitë e Qeverisjes Vendore.

*Menjëherë*

**A.5.** Praktikrat Doganore të eksportit të Mineralit të Kromit në llogaritjen e detyrimeve për Taksën Kombëtare të Rentës Minerare në çdo rast të bazohen në çmimin real të shitjes së Mineralit të Kromit dhe në të dhënat zyrtare për këtë qëllim (çmimet e azhuruara).

*Menjëherë*

**A.6.** Drejtoria e Përgjithshme e Doganave brenda afateve të përcaktuara të informojë Ministrinë e Financave, për shumën e arkëtuar të Taksës së Rentës Minerare sipas Degëve Doganore, subjekteve dhe NJQV-ve ku ushtrojnë aktivitetin këta subjekte. Në zbatim të ligjit për Buxhetin e Shtetit të përcaktojë shumën e fondeve që duhet alokuar për çdo NJQV.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Nga 4 masa “Shpërblim dëmi”, të rekomanduara nga KLSH në vlerën 3,321,665,015 lekë, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, janë zbatuar 2 masa në vlerën 1,481,097 lekë, 1 masë është zbatuar pjesërisht në vlerën 5,289,821 lekë (nga 7,736,736 lekë të kërkuara) dhe 1 masë në vlerën 3,312,447,182 lekë është në proces zbatimi (për të cilën është kërkuar shtyrje afati).

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 33-47 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve:*

**B.1.** Dega e Doganës Vlorë, me marrjen e përgjigjeve nga doganat homologe, mbi verifikimin e dokumentacionit doganor për naftën bruto, të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit prej 3,312,447,182 lekë nga 3 subjekte eksportues [REDAKTUAR] në total prej 2,940,174,914 lekë; [REDAKTUAR] në total prej 290,932,489 lekë, dhe [REDAKTUAR] në total prej 80,339,779 lekë, pasqyruar më hollësisht në anekset nr. 1-5 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, dërguar me shkresën nr. 1101/17, datë 06.05.2015.

*Brenda datës 30.01.2016*

## **C. MASA DISIPLINORE**

Nga 15 masa disiplinore të rekomanduara, rezulton se janë zbatuar 3 masa disiplinore dhe në 12 raste nuk ka filluar procedimi disiplinor.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 33-47 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve:*

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rikërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe Kryetarëve të Degëve Doganore, që në vlerësimin e shkeljeve sipas shkallës së përgjegjësisë për punonjësit e atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe që janë aktualisht në sistemin doganor sipas Degëve Doganore, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave për shqyrtimin e dhënien e masave përkatëse disiplinore të pa zbatuara nga “Vërejtje” deri në “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 1 vjeçare”, sipas VKM nr. 115, datë 5.3.2014 dhe ligjit nr. 152/2013, **për 12 nëpunës** në Degët Doganore si më poshtë:

a. Dega e Doganës Vlorë, **3 nëpunës**.

b. Dega e Doganës Durrës, **1 nëpunës**.

c. Dega e Doganës Kakavijë, **7 nëpunës**.

d. Dega e Doganës Fier, **1 nëpunës**.

#### **D. MASA ADMINISTRATIVE**

Është rekomanduar 1 masë administrative, e cila rezulton e pazbatuar.

Sa më sipër, trajtuar në faqet 33-47 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimit:

**D. 1.** Nga llogaritja e rentës minerare bazuar në të dhënat e disponueshme; në vitin 2013 konstatohet një e ardhur e munguar nga 9 subjekte për shumën prej 16,258,086 lekë; në vitin 2014 konstatohet një e ardhur e munguar nga 7 subjekte për shumën prej 41,576,725 lekë.

Drejtoria e Vlerës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në zbatim të pikës 7 të VKM-së nr. 7 datë 04.01.2012, duhet të paraqesë vlerën e tregjeve të mineraleve për mineralet e Hekur Nikelit të eksportuar. Në përputhje e në zbatim të tyre Dega e Doganës Qafë Thanë të bëjë llogaritjen e Borxhit Doganor për Taksës së Rentës Minerare dhe të rillogariten detyrimet për periudhën e audituar e në vazhdim.

*Menjëherë*

#### **3. DREJTORIA E LABORATORIT DOGANOR, NË DPD**

Mbi auditimin e performancës me objekt: “**Mbi vlerësimin dhe certifikimin e mallrave në sistemin doganor shqiptar dhe marrëdhëniet e laboratorit doganor me degët doganore dhe biznesin**” zhvilluar në periudhën nga data 01.08.2014 deri më 21.11.2014 dhe finalizuar me Vendimin Nr. 191, datë 31.12.2014 të Kryetarit të KLSH-së. Rekomandimet dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit u përcollën në subjekt me shkresën nr. 537/6, datë 20.01.2015.

-Nga DLD në DPD, është kthyer përgjigje, brenda afatit 20 ditor për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga DLD në DPD, është kryer monitorimi i realizimit të Plan-veprimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar shkresën nr. 537/6, datë 20.01.2015.

Sa më sipër, i është rikërkuar që, në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të raportohet (me shkrim) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke njoftuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

*Menjëherë*

Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Drejtorisë së Laboratorit Doganor dhe Degëve Doganore, i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar shkresën nr. 537/6, datë 20.01.2015,



protokolluar në DPD me nr. 1931, datë 23.01.2015, mbi auditimin e performancës me objekt “Mbi vlerësimin dhe certifikimin e mallrave në sistemin doganor shqiptar dhe marrëdhëniet e laboratorit doganor me degët doganore dhe biznesin”, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, ose të zbatuara pjesërisht, si më poshtë:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

Nga 15 masa organizative të rekomanduara, 8 masa rezultojnë të zbatuara, 4 masa janë zbatuar pjesërisht, 1 masë në proces zbatimi dhe 2 masa rezultojnë të pa zbatuara.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 47-54 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve:*

**A.3.** DPD të marrë masa të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të punës të Drejtorisë së Laboratorit Doganor, në funksion të:

- Sigurimit të ambienteve të nevojshme, kryerjen e investimeve të menjëhershme edhe në ambientet e ekzistuese të DLD-së, si një domosdoshmëri dhe në funksion të procesit të akreditimit.
- Krijimit të kushteve optimale për shëndetin e punonjësve, duke bërë në mënyrë periodike matjen e nivelit të lëndëve të dëmshme për shëndetin në ambientet e punës, nga institucione të autorizuar.
- Të kryhen ekzaminime periodike shëndetësore të punonjësve.
- Marrjes së masave për ruajtjen e administrimin e mostrave në kushte optimale, plotësimin e standardeve, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin e Mostrimit dhe Manualin e Cilësisë.

***Menjëherë dhe vijimësi***

**A.5.** DLD në bashkëpunim me DPD të nisë bashkëpunimin me laboratorët rajonalë, për njohjen e kapaciteteve teknike dhe analitike, me qëllim jo vetëm të shkëmbimit të eksperiencave, por edhe të plotësimit të nevojave të ndërsjella duke ulur kostot e shërbimit.

***Menjëherë dhe vijimësi***

**A.6.** Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të merret në konsideratë objekti i punës së laboratorëve doganorë evropianë, praktikat më të mira të tyre, me qëllim ristrukturimin e objektit të punës të DLD-së, fokusimin e tij vetëm në dhënien e rezultateve të analizave laboratorike.

***Menjëherë***

**A.8.** DPD, të marrë masa për zgjidhjen e problematikave që hasin Degët Doganore në marrjen e mostrave, ruajtjen e mostrave dhe transportin e tyre në DLD. Kjo vlen si për mjetet e transportimit edhe për personin shoqëruar të saj, në zbatim të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin “Mbi procedurat e mostrimit, transportimit, ruajtjes së mostrave dhe administrimit të rezultateve të analizave laboratorike”.

***Menjëherë***

**A.9.** Degët Doganore, të marrin masa për zbatimin e kërkesave të përcaktuara në Manualin e Cilësisë mbi shoqërimin e mostrave me skadat teknike, të cilat dërgohen për analizim në DLD, veçanërisht për analizimin e produkteve të veçanta si: aditivë të vajrave lubrifikantë, ushqim për kafshë etj.

***Menjëherë***

**A.10.** Nga DPD nëpërmjet strukturave të saj të monitorohet dërgimi në rrugë zyrtare të përgjigjeve të analizave subjekteve private prej Degëve Doganore.

***Menjëherë***

#### **4. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE**

Mbi auditimin me objekt: “**Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare për periudhën 01.10.2013 – 31.12.2014**”, zhvilluar në periudhën nga data 01.06.2015 deri më 27.07.2015 dhe finalizuar me Vendimin Nr. 126, datë 21.09.2015 të Kryetarit të KLSH-së. Rekomandimet dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit u përcollën në subjekt me shkresën nr. 509/33, datë 22.09.2015.

-Nga DPT, është zbatuar brenda afatit të përcaktuar detyrimi ligjor prej 20 ditë mbi hartimin e plan-veprimit dhe kthimin e përgjigjes KLSH për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga DPT, është kryer monitorimi i realizimit të Plan-veprimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar shkresën nr. 509/33 prot, datë 22.09.2015.

*Sa më sipër, është rikërkuar* që, në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda 6 muajve, duke njoftuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve *është rikërkuar* zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së, dërguar me shkresën nr. 509/33 prot, datë 22.09.2015, lidhur me auditimin me objekt “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare për vitin 2014”, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi, ose të pa pranuar si më poshtë:

#### **A.MASA ORGANIZATIVE**

Nga 8 masa organizative të rekomanduara për zbatim janë realizuar plotësisht 5 masa dhe janë në proces zbatimi 3 masa organizative.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 65-72 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve:*

**A.3-**Të merren masat nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, që në çdo fillim viti, të evidentohet vjetërsia e punës për çdo nëpunës për efekt pagese, duke e cilësuar vjetërsinë e punës sipas librezës së punës.

*Menjëherë*

**A.4-**Nga DPT të ngrihet grup pune i përbërë nga specialistë të kualifikuar dhe me përvojë, nën drejtimin e Drejtorisë Teknike në DPT të vlerësohet, sipas një programi specifik, ngarkesa në punë për çdo pozicion pune në DPT, të propozohen ndryshimet respektive për strukturën e DPT dhe të hartohet rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e DPT dhe DRT”, me qëllim që të përfshihen në mënyrë të detajuar kompetencat dhe përgjegjësitë për çdo pozicion pune nëpërmjet mekanizmave të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

**Në Vijimësi**

**A.8-**Të merren masat nga DPT për të ardhmen, që procesi i kryerjes së inventarizimit të aktiveve të institucionit të përfundojë brenda vitit ushtrimor me qëllim që rezultati i tyre të paraqitet në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor përkatës.

*Në Vijimësi*

## **B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Nga 2 masa “Shpërblim dëmi”, të rekomanduara nga KLSH në vlerën 7,515 mijë lekë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, i ka marrë në shqyrtim por nuk ka pranuar zbatimin e tyre.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 65-72 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve:*

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të rikërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 7,515 mijë lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, si më poshtë:

**B.2.** Vlera prej 5.788 mijë lekë, nga 5 anëtar të KVO-së, të cilët kanë shpallur fitues ofertën me vlerën më të lartë duke sjelle pabarazi në tender.

*Menjëherë*

**B.3.** Vlera prej 1,727 mijë lekë nga [REDAKTUAR], për përzgjedhje, propozim dhe autorizim të likuidimit të shpenzimeve ekstra për likuidimin e komisioneve bankare të përdorimit të letër kredisë për likuidimin e shpenzimeve për investime në fund të vitit 2014, në vend të instrumenteve të tjera të pagesave të zakonshme, të cilat janë me komision zero, për 9 kontrata të fund vitit 2014, të likuiduara nëpërmjet këtij instrumenti pagesë.

*Menjëherë*

## **C. MASA DISIPLINORE**

Nga 2 masa disiplinore të rekomanduara, rezulton se është marrë në shqyrtim dhe nuk është pranuar zbatimi i 1 mase, ndërsa masa tjetër akoma nuk është marrë në shqyrtim.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 65-72 të RPA rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve:*

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të rivlerësojë shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të bëjë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për dhënien e masave disiplinore sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 58, germa (ç) Largim nga shërbimi civil, për nëpunësit civil si më poshtë:

**1-** [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

**2.** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të vlerësojë shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të bëjë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për dhënien e masave disiplinore sipas VKM nr.115, datë 05.03.2014 dhe ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, sipas natyrës së shkeljeve për nëpunësit e tjerë civil të DPT, që janë atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

*Menjëherë*

## **5.DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE-RENTA MINERARE**

Mbi auditimin me objekt: “Mbi administrimin e Taksës Minerare, realizimin e të ardhurave tatimore dhe vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të aktiviteteve që nxjerrin, tregtojnë apo eksportojnë minerale dhe nënprodukte të tyre për vitet 2013, 2014” zhvilluar në periudhën nga data 25.03.2015 deri më 20.07.2015 dhe finalizuar me Vendimin Nr. 132, datë 25.09.2015 të Kryetarit të KLSH-së. Rekomandimet dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit u përcollën në subjekt me shkresën nr. 286/18, datë 28.09.2015.

-Nga DPT, nuk është zbatuar detyrimi ligjor për njoftimin e KLSH brenda 20 ditëve mbi hartimin e plan-veprimit për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga DPT, është në proces monitorimi i realizimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar shkresën nr. 286/18, datë 28.09.2015.

*Sa më sipër, është rikërkuar* që, në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit *brenda 6 muajve*, duke njoftuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguara me shkresën nr. 286/18, datë 28.09.2015 mbi auditimin me objekt “Mbi administrimin e Taksës Minerare, realizimin e të ardhurave tatimore dhe vlerësimin e veprimtarisë ekonomiko-financiare të aktiviteteve që nxjerrin, tregtojnë apo eksportojnë minerale dhe nënprodukte të tyre”, të cilat nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pa zbatuara apo në proces zbatimi, si më poshtë:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

Nga 5 masa organizative të rekomanduara janë zbatuar plotësisht 3 masa, 1 masë është zbatuar pjesërisht ndërsa 1 masë nuk është zbatuar.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 72-79 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve:*

**A.2.** Në Drejtorinë Rajonale Tatimore të analizohet niveli i ulët i deklarimit të shitjeve dhe të ardhurave nga Taksa e Rentës Minerare për subjektet që i nënshtrohen kësaj takse dhe të merren masa konkrete për përmirësimin e gjendjes duke ushtruar kontrolle tatimore në këta subjekte.

*Menjëherë*

**A.5.** Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore të merren masa për një bashkëpunim më të mirë me strukturat e Sistemit Doganor për marrjen dhe shpërndarjen e informacionit shtesë për vendimet që nxjerrin Degët Doganore, kjo edhe në zbatim të marrëveshjeve të përbashkëta të lidhura midis Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

*Menjëherë*

## **B. MASA SHPERBLIM DEMI**

Nga 6 masa për shpërblim demë të rekomanduara në vlerën 118,832 mijë lekë, rezulton se janë pranuar dhe është në proces zbatimi i tyre.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 72-79 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve:*

Drejtorinë e Përgjithshme e Tatimeve të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 118,832 mijë lekë, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

**B.1.** Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, të marrë masa për të përlllogaritur e kontabilizuar detyrimet tatimore të pa përlllogaritura dhe të pa kontabilizuara në shumën 26,915 mijë lekë nga 3 subjekte.

*Menjëherë*

**B.2.** Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës, të marrë masa për të përlllogaritur e kontabilizuar detyrimet tatimore të pa përlllogaritura dhe të pa kontabilizuara në shumën 24,377 mijë lekë nga 7 subjekte.

*Menjëherë*

**B.3.** Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, të marrë masa për të përlloritur e kontabilizuar detyrimet tatimore të pa përlloritura dhe të pa kontabilizuara në shumën *37,659 mijë lekë* nga 16 subjekte.

*Menjëherë*

**B.4.** Drejtoria e Tatimpagueseve të Mëdhenj, Tiranë të marrë masa për të përlloritur e kontabilizuar detyrimet tatimore të pa përlloritura dhe të pa kontabilizuara në shumën *11,260 mijë lekë* nga 5 subjekte.

*Menjëherë*

**B.5.** Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, të marrë masa për të përlloritur e kontabilizuar detyrimet tatimore të pa përlloritura dhe të pa kontabilizuara në shumën *18,254 mijë lekë* nga 12 subjekte:

*Menjëherë*

**B.6.** Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, të marrë masa për të përlloritur e kontabilizuar detyrimet tatimore të pa përlloritura dhe të pa kontabilizuar në shumën *367 mijë lekë* nga 1 subjekt.

*Menjëherë*

## **C. MASA DISIPLINORE**

Nga 11 masa disiplinore të rekomanduara, rezulton se është zbatuar 1 masë, 2 masa konsiderohen të realizuara pasi punonjësit janë larguar nga sistemi tatimor dhe 8 masa rezultojnë të pazbatuara.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 72-79 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve:*

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, *i rikërkojmë* Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe Drejtorëve të Drejtorive Rajonale Tatimore, që në vlerësim të shkeljeve sipas shkallës së përgjegjësisë për punonjësit e atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe që janë aktualisht në sistemin tatimor sipas Drejtorive Rajonale Tatimore, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave për shqyrtimin e dhënien e masave përkatëse disiplinore të pa zbatuara nga “*vërejtje*” deri në “*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 1 vjeçare*”, sipas VKM nr. 115, datë 5.3.2014 dhe ligjit nr. 152/2013, për **8 nëpunësit** në DRT si më poshtë:

a. *Drejtoria Rajonale Tatimore Dibër, 6 nëpunës.*

b. *Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës, 1 nëpunës*

c. *Drejtoria Rajonale Tatimore Kukës, 1 nëpunës.*

## **6. DEGA E DOGANËS TIRANË**

Mbi auditimin me objekt: “**Mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare për vitin 2014**” zhvilluar në periudhën nga data 20.05.2015 deri më 24.06.2015 dhe finalizuar me Vendimin Nr. 112, datë 08.09.2015 të Kryetarit të KLSH-së. Rekomandimet dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit u përcollën në subjekt me shkresën nr. 409/13, datë 09.09.2015.

-Nga Dega e Doganës Tiranë, është kthyer përgjigje brenda afatit të përcaktuar, mbi hartimin e plan-veprimit për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga DDT, është kryer monitorimi i realizimit të Plan-veprimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar shkresën nr. 409/13, datë 09.09.2015.

Sa më sipër, rikërkojmë që, në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit *brenda 6 muajve*, nga data e marrjes së Raportit Përfundimtar dhe rekomandimeve, duke njoftuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

***Deri më datë 9.03.2016***

Degës së Doganës Tiranë, *i është rikërkuar* zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 409/13, datë 09.09.2015, mbi auditimin me objekt “Mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare”, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara apo të zbatuara pjesërisht si më poshtë:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

Nga 11 masa organizative të rekomanduara, rezulton se janë zbatuar plotësisht 10 masa dhe 1 masë është në proces zbatimi, pra realizuar në masën 100%.

#### **B. MASA PËR SHPËRBILM DËMI**

Nga 6 masa “Shpërblim dëmi”, të rekomanduara nga KLSH në vlerën 130,438 mijë lekë, nga Dega e Doganës Tiranë, janë realizuar plotësisht 4 masa, janë nxjerrë vendimet administrative për vlerën 61,486 mijë lekë, nuk janë pranuar për arsye objektive për vlerën 6,227 mijë lekë dhe 2 masa janë në proces zbatimi.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 85-94 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve në vlerën 62,725 mijë leke:*

**B.1.** Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës së mbetur prej 5,144 mijë lekë detyrime nga 14 raste të sipas subjekte në aneksin nr. 1 të Raportit Përfundimtar të Auditimit të dërguar me shkresën nr. 409/13, datë 09.09.2015.

***Menjëherë***

**B.2.** Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej 57,581 mijë lekë detyrime dhe penalitete nga 41 subjekte sipas Aneksit 3, trajtuar në faqet 135-149 të Raportit Përfundimtar të Auditimit të dërguar me shkresën nr. 409/13, datë 09.09.2015.

***Menjëherë***

#### **C. MASA DISIPLINORE**

Nga 9 masa disiplinore të rekomanduara, rezulton se janë zbatuar plotësisht 4 masa disiplinore, për 4 punonjës, çështjet i janë përcjellë DPD-së pasi këto punonjës janë transferuar në degë të tjera doganore dhe për 1 punonjës pas shqyrtimit të masës së propozuar “vërejtje”, është konkluduar me mosdhënie të saj.

#### **7. DEGA DOGANËS LEZHË**

Mbi auditimin me objekt: “**Mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare për vitet 2013, 2014**” zhvilluar në periudhën nga data 05.01.2015 deri më 13.02.2015 dhe finalizuar me Vendimin Nr. 27, datë 25.03.2015 të Kryetarit të KLSH-së. Rekomandimet dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit u përcollën në subjekt me shkresën nr. 1209/7, datë 25.03.2015.

-Nga Dega e Doganës Lezhë, nuk është zbatuar detyrimi ligjor prej 20 ditë mbi kthimin e përgjigjes KLSH për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga DDL, është kryer monitorimi i realizimit të Plan-veprimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 1209/7, datë 25.03.2015 dhe është njoftuar KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, por duke tejkaluar afatin 6 mujor përcaktuar në nenin 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Degës së Doganës Lezhë, i është rikëruar zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 1209/7, datë 25.03.2015, mbi auditimin me objekt “Mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare” të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, si më poshtë:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

Nga 5 masa organizative të rekomanduara, 3 masa rezultojnë të zbatuara dhe 2 masa rezultojnë të pa zbatuara.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 95-106 të RPA i është rikëruar zbatimi i rekomandimeve:*

**A.1.** Dega e Doganës Lezhë të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme nga KLSH.

*Menjëherë*

**A.3.** Dega e Doganës Lezhë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të marrë masat për të parë mundësinë e sistemimit në ambiente të tjera, pronë e enteve shtetërore apo ndërtimin e tyre me synim mënjanimin e shpenzimeve të tilla të mëdha që vazhdojnë të kryhen nga pagesa e lartë e qerasë 300 mijë lekë/muaj.

*Menjëherë*

#### **B. MASA PËR SHPËRBILM DËMI**

Nga 6 masa “Shpërblim dëmi”, të rekomanduara nga KLSH në vlerën 45,755 mijë lekë, nga Dega e Doganës Lezhë, janë realizuar plotësisht 3 masa, janë nxjerrë vendimet administrative për vlerën 7,271 mijë lekë. Për vlerën 10,108 mijë lekë nuk janë pranuar për arsye objektive dhe 3 masa janë realizuar pjesërisht.

Vlera prej 20,400 mijë lekë, është në proces zbatimi për arsye se çështja është në proces gjygjësor në Gjykatën e Lartë, masa konsiderohet në proces.

Vlera prej 3.612 mijë lekë, është në proces zbatimi për arsye se çështja është dërguar për konfirmim pranë DPD dhe pritet përgjigje e konfirmimit nga autoritetet doganore.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 95-106 të RPA i është rikëruar zbatimi i rekomandimeve në vlerën 4,364 mijë lekë:*

**B.2.** Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës së mbetur prej 1,176 mijë lekë detyrime për 11 raste sipas subjekteve në aneksin nr. 5 të RPA, të dërguar me shkresën nr. 1209/7, datë 25.03.2015.

*Menjëherë*

**B.4.** Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës së mbetur prej 3,188 mijë lekë detyrime për 38 raste sipas subjekteve në aneksin nr. 2 dhe nr. 3 të RPA, dërguar me shkresën nr. 1209/7, datë 25.03.2015.

*Menjëherë*

## C. MASA DISIPLINORE

Nga 4 masa disiplinore të rekomanduara, rezulton se është zbatuar 1 masa disiplinore, për 1 punonjës, çështja i është përcjellë DPD-së për kompetence dhe për 2 punonjës pas shqyrtimit të masës së propozuar, është konkluduar me mosdhënie të saj.

## **8. DEGËS SË DOGANËS SHKODËR**

Mbi auditimin me objekt: “**Mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare për vitet 2013, 2014**” zhvilluar në periudhën nga data 05.01.2015 deri më 27.02.2015 dhe finalizuar me Vendimin Nr. 39, datë 31.03.2015 të Kryetarit të KLSH-së. Rekomandimet dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit u përcollën në subjekt me shkresën nr. 1208/8, datë 31.03.2015.

-Nga Dega e Doganës Shkodër, nuk është zbatuar detyrimi ligjor prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes KLSH për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga DDSH, është kryer monitorimi i realizimit të Plan-veprimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar shkresën nr. 1208/8, datë 31.03.2015 si dhe është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 6 muajsh, në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, duke njoftuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Degës së Doganës Shkodër, *i rikërkojme* zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 1208/8, datë 31.03.2015, mbi auditimin me objekt “Mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare” të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara, ose të zbatuara pjesërisht, si më poshtë:

## A. MASA ORGANIZATIVE

Nga 11 masa organizative të rekomanduara, 10 masa rezultojnë të zbatuara dhe 1 mase rezulton e pa zbatuar.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 107-117 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve:*

**A.9.** Dega e Doganës Shkodër në bashkëpunim me DPD, të marë masa që në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në KD, VKM nr. 205, datë 13.05.1999 “Për dispozitat zbatuese të KD”, udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 25, datë 30.11.2017 “Për verifikim e vlerës doganore”, si dhe udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2011 “Mbi procedurën e përpunimit të deklaratës doganore (DAV) në sistemin Asycuda Eorld”, të gjejnë zgjidhjen e duhur.

*Menjëherë*

## B. MASA PËR SHPËRBILM DËMI

Nga 12 masa “Shpërblim dëmi”, të rekomanduara nga KLSH në vlerën 34,150 mijë lekë, nga Dega e Doganës Shkodër janë realizuar plotësisht 9 masa, janë nxjerrë vendimet administrative për vlerën 5,860 mijë lekë. Për vlerën 21,251 mijë lekë nuk janë pranuar për arsye objektive dhe 3 masa janë realizuar pjesërisht.

Vlera prej 5,213 mijë lekë, është në proces zbatimi për arsye se çështja është dërguar për konfirmim pranë DPD dhe pritet përgjigje e konfirmimit nga autoritetet doganore.



*Sa më sipër, trajtuar në faqet 107-117 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve të pazbatuara në vlerën 1,826 mijë lekë:*

**B.1.** Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës së mbetur prej 367 mijë lekë detyrime për subjektin [REDAKTUAR] në aneksin nr. 1 të RPA të dërguar me shkresën nr. 1208/8, datë 31.03.2015.

*Menjëherë*

**B.2.** Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës së mbetur prej 496 mijë lekë detyrime për 5 raste sipas subjekteve në aneksin nr. 2 të RPA të dërguar me shkresën nr. 1208/8, datë 31.03.2015.

*Menjëherë*

**B.3.** Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës së mbetur prej 963 mijë lekë detyrime për 2 raste sipas subjekteve në aneksin nr. 3 të RPA të dërguar me shkresën nr. 1208/8, datë 31.03.2015.

*Menjëherë*

## **C. MASA DISIPLINORE**

Nga 16 masa disiplinore të rekomanduara, rezulton se nuk është realizuar asnjë masë.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 107-117 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve:*

**C.1.** Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rikërkojmë Degës së Doganës Shkodër, të fillojë procedurat për të kaluar në Komisionin Disiplinor, sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 për shkeljet e konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda, të urdhërojë fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe dhënien e masës për **16 punonjës:**

a) “Mbajtjen deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë 3 mujore”, për **6 punonjës.**

b) “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë 1 vjeçare”, për **10 punonjës.**

## **9. DEGA E DOGANËS DURRËS**

Mbi auditimin me objekt: “**Mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare për vitin 2014**” zhvilluar në periudhën nga data 02.06.2015 deri më 24.07.2015 dhe finalizuar me Vendimin Nr. 135, datë 30.09.2015 të Kryetarit të KLSH-së. Rekomandimet dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit u përcollën në subjekt me shkresën nr. 543/18, datë 30.09.2015.

-Nga Dega e Doganës Durrës, është kthyer përgjigje brenda afatit të përcaktuar, mbi hartimin e plan-veprimit për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga Dega e Doganës Durrës, është kryer monitorimi i realizimit të Plan-veprimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar shkresën nr. 543/18, datë 30.09.2015.

*Sa më sipër i është rikërkuar që, në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të raportohet (me shkrim) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit brenda 6 muajve, duke njoftuar mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.*

Degës së Doganës Durrës, i rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 543/18, datë 30.09.2015, protokolluar në Degën e Doganës Durrës me nr. 6859/8, datë 30.09.2015, mbi auditimin me objekt “Mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare”, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara apo të zbatuara pjesërisht, duke vënë në dijeni dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për problematikën e ripërsëritur nga Dega Doganore Durrës, për vlerësimin me dy standarde të praktikave doganore të subjektit ■■■, në raport me subjektet e tjera të cilat operojnë në këtë treg dhe trajtimin e tyre në mënyrë të barabartë para kërkesave të ligjit, si më poshtë:

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

Nga KLSH, janë lënë 16 rekomandime “Masa organizative”, për të cilat nga Dega e Doganës Durrës, rezultojnë të zbatuara 11 masa dhe në proces janë 5 masa.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 118-130 të RPA i është rikëruar zbatimi i rekomandimeve:*

**A.1.** Nga Dega Doganore Durrës, të rishqyrtohen dhe të nxirren vendimet për diferencën 53,972,393 lekë për vitin 2012, detyrime të papaguara të subjektit ■■■ dhe të pa përfshira në vendimin nr. 145, datë 29.01.2015 nga e cila:

- vlera në shumën 10,457,987 lekë detyrime doganore.
- vlera në shumën 43,559,406 lekë detyrime, për 12 raste sipas aneksit nr. 4, për të cilat DDD duhet të rishqyrtojë dhe të përllogarisë detyrimet doganore mbi çmimin sipas të dhënave të disponueshme, duke aplikuar penalitetet në masën 3 fish në zbatim të nenit 261.2 të Kodit Doganor.

Dega Doganore Durrës, të korrektojë detyrimin e subjektit ■■■ për vitin 2013, i cili në total bëhet 69,510,686 lekë, duke reflektuar ndryshimin e detyrimit për 4 deklaratat e mësipërme. Të rishqyrtojë dhe të nxjerrë vendimet përkatëse, për diferencën 10,824,655 lekë, për vitin 2013, detyrime të papaguara të subjektit ■■■ dhe të pa përfshira në vendimin nr. 145, datë 29.01.2015.

***Menjëherë***

**A.2.** Dega Doganore Durrës të marrë masa të menjëhershme për ndërprerjen e vlerësimit me dy standarde të praktikave doganore import 4 të subjektit ■■■ të artikujve “veshje të këmbës”, në raport me subjektet e tjera të cilat operojnë në këtë treg dhe trajtimin e tyre në mënyrë të barabartë para kërkesave të ligjit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**A.3.** Dega Doganore Durrës, për të gjitha rastet e evidentuara për subjektin ■■■ për çdo DAV, sipas aneksit nr. 1 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit të dërguar me shkresën nr. 543/18, datë 30.09.2015, të përllogarisë penalitetet përkatëse në zbatim të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

***Menjëherë***

**A.4.** Dega e Doganës Durrës, me përfundimin e procesit të verifikimeve në doganat homologe, verifikimin e vertetësisë së vlerave të faturave për subjektin ■■■ kthimin e përgjigjeve nga DPD si dhe marrjen e vendimeve për rekomandimet e mësipërme, të cilat nga auditimi kanë rezultuar se janë në proces verifikimi, apo të realizuara pjesërisht, duhet të njoftojë menjëherë Kontrollin e Lartë të Shtetit.

***Në vijimësi***

**A.14.** Dega e Doganës Durrës të marri masa konkrete në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për largimin e mallrave të sekuestruara (gomave dhe frigoriferëve të përdorur), nga ambientet e magazinimit provizor, sipas procedurave ligjore.

*Menjëherë*

*Për sa më sipër* lidhur me problematikën e ripërsëritur nga Dega Doganore Durrës, për vlerësimin me dy standarde të praktikave doganore të subjektit. ■■■ kërkojmë që, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të analizojë këtë problematikë dhe të kthejë përgjigje KLSH brenda 20 ditëve, përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Nga KLSH, janë lënë 10 rekomandime “Masa për shpërblim dëmi”, në vlerën 143,075 mijë lekë, për të cilat nga Autoriteti Doganor Durrës, me shkresën nr. 6859/11 prot, datë 09.10.2015 “*Program pune*” ka hartuar plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve. Rekomandimet janë në proces shqyrtimi dhe analizimi nga grupet e punës të ngritura për këtë qëllim, brenda afateve të përcaktuara.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 118-130 të RPA i rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve:*

**B.1.** Vlera prej 44,007 mijë lekë detyrime doganore (taksë doganore dhe tvsh), (si dhe vlera e penaliteteve të cilat, duhet të përlllogariten nga DDD, në zbatim të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar), për 28 raste të subjektit ■■■ sipas aneksit nr. 1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, pasi nga Dega Doganore Durrës, vlerësimi i deklaratave Imp 4, të këtij subjekti është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; të pikës 15.13 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, si dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 25 datë 30.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre”.

*Menjëherë*

**B.2.** Vlera prej 30,463 mijë lekë detyrime doganore (taksë doganore dhe tvsh), (si dhe vlera e penaliteteve të cilat, duhet të përlllogariten nga DDD, në zbatim të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar), për 74 raste sipas aneksit nr. 1, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, pasi nga Dega Doganore Durrës, vlerësimi i deklaratave Imp4, të këtyre subjekteve është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; të pikës 15.13 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor”, si dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 25 datë 30.11.2007 “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre”.

*Menjëherë*

**B. 3.** Vlera prej 45,863 mijë lekë detyrime dhe penalitete të pa zbatuara nga shkeljet e legjislacionit doganor gjatë nxjerrjes së vendimeve administrative për 130 subjekte, sipas aneksit nr. 2.

*Menjëherë*

**B. 4.** Vlera prej 13,326 mijë lekë penalitete të pazbatuara nga DDD në 26 raste, sipas aneksit nr. 7 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, për mbylljen me vonesë të tranziteve

(ndërkombëtare), në kundërshtim me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” me ndryshime, neni 260.

**Menjëherë**

**B. 5.** Vlera prej 3,552 mijë lekë penalitete të pazbatuara nga DDD në 11 raste, sipas aneksit nr. 6 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, për mbylljen me vonesë të tranziteve (të brendshme), në kundërshtim me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” me ndryshime, neni 260.

**Menjëherë**

**B. 6.** Vlera prej 2,800 mijë lekë penalitete të pazbatuara nga DDD në 14 raste, sipas aneksit nr. 8 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, në kundërshtim me ligjin nr. 61/2012 datë 05.04.2012 “Për akcizën në RSH” me ndryshime, VKM-në nr. 612, datë 05.09.2012, si dhe nenit 85 të Kreut "Shkeljet në fushën e akcizës dhe sanksionet" pika 1/a "Kundërvajtje Administrative" dhe nenit 96/1 pika 1.

**Menjëherë**

**B. 7.** Vlera prej 1,400 mijë lekë penalitete të pazbatuara nga DDD në 8 raste, sipas aneksit nr. 5 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, për magazinat doganore, në kundërshtim me ligjin nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” me ndryshime, nenet 121-135, VKM nr. 205 datë 13.04.1999 me ndryshime, Kreu 2 “Magazinimi doganor” nenet 240-271, si dhe udhëzimit nr. 3 datë 09.02.2006 “Për zbatimin praktik të përfitimit dhe operimit me regjimin e magazinimit doganor”.

**Menjëherë**

**B. 8.** Vlera prej 800 mijë lekë, penalitete për 12 subjekte që kanë operuar në Regjimin e Përpunimit Aktiv, sipas aneksit nr. 3, të PRA, për mos dorëzimin e dokumentit për mbylljen e regjimit dhe mungesën e disa dokumenteve në dosjet e audituara.

**Menjëherë**

**B.9.** Në 12 raste, për vendosjen e penaliteteve në shumën 600 mijë lekë, sipas aneksit nr. 9 bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit të dërguar me shkresën nr. 543/18, datë 30.09.2015, pasi nga DDD nuk janë aplikuar penalitete në kundërshtim me ligjin nr. 61/2012 datë 05.04.2012 “Për akcizën në RSH” me ndryshime, neni 54, pika 7, si dhe në bazë të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999, “Kodi doganor i RSH” neni 256, paragrafi 2 si dhe neni 275 paragrafi i parë, subjekti penalizohet me 50,000 lekë për çdo rast.

**Menjëherë**

**B.10.** Në 3 raste, për detyrim akcize të papaguar dhe penalitet në vlerën 264 mijë lekë, nga subjektet ■■■■■ në vlerën 102,000 lekë, ■■■■■ në vlerën 88,200 lekë dhe ■■■■■ në vlerën 74,160 lekë, në zbatim të ligjit (me ndryshime) neni 89 “Shmangia nga verifikimi dhe nga pagimi i akcizës për alkolin dhe pijet alkoolike” pika 1/1.1 ku cilësohet: “Për herën e parë të konstatuar, me gjobë sa 2-fish i detyrimeve fiskale që duheshin paguar për këto produkte të akcizës”.

**Menjëherë**

## **C. MASA DISIPLINORE**

Janë rekomanduar 8 masa disiplinore të cilat rezultojnë në proces zbatimi.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 118-130 të RPA i rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve:*

Nga KLSH, mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e

vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rikerkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe Drejtorit të Doganës Durrës, që në vlerësim të shkeljeve, të konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda dhe shumë të rënda, të bëjë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, për shqyrtimin dhe dhënien e masave nga “vërejtje” deri në “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” për **8 nëpunës** të Degës Doganës, Durrës.

**Në përfundim të auditimit** “Mbi verifikimin e zbatimit të masave të rekomanduara në auditimet e mëparshme”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1019/1, datë 21.11.2015 të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, ka rezultuar se nga Dega e Doganës Durrës, nuk janë zbatuar disa prej rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në auditimin e mëparshëm ridërguar me shkresën nr. 543/18, datë 30.09.2015 për rizbatimin e rekomandimeve të lëna me shkresën nr. 12/10, datë 30.06.2014. Sa më sipër **është rekomanduar**:

#### **A. MASA DISIPLINORE:**

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave që në vlerësim të shkeljes së kryer nga ish-Kryetari i Degës së Doganës Durrës, të konsideruar nga ana jonë si shkelje e rëndë, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse, për dhënien e masës disiplinore sipas VKM nr. 115, datë 05.03.2014 dhe ligjit nr. 152/2013, për moszbatim të rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën nr. 12/10 datë 30.06.2014.

Për sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” neni 58 germa (ç), rekomandohet masa disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, për:

1. ■■■■■, me detyrë ish Kryetar i Degës së Doganës Durrës, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, mbi detyrimet doganore të papaguara nga subjekti ■■■■■ për vitin 2012, 2013.

Pasi, mbështetur në konstatimet e bëra, në faktet dhe provat dokumentare, në drejtim të zbatimit të ligjshmërisë, për nxjerrjen e vendimeve në zbatim të rekomandimit të lëna nga KLSH, për “shpërblim dëmi” nga subjekti ■■■■■ si dhe ekzekutimin e tyre nga Dega Doganës Durrës. *Konkretisht:*

-Me vendimin nr. 145, datë 29.01.2015 të nxjerrë nga ish Kryetari i DDD ■■■■■ mbi përcaktimin e detyrimeve që do të paguajë subjekti ■■■■■ **nuk është marrë në konsideratë i gjithë detyrimi (taksë doganore dhe tvsh) i kërkuar për zhdëmtim nga KLSH**, pavarësisht se me vendimin nr. 145, datë 29.01.2015, kjo metodë e vlerësimit doganor është pranuar.

-Ish Kryetari i DDD, me vendimin nr. 145/1 datë 06.02.2015, **ka pezulluar** efektet e vendimit nr. 145, datë 29.01.2015, të dalë po prej tij **vetëm 8 ditë pas nxjerrjes së këtij vendimi**.

Nga KLSH është vënë theksi mbi standardin e dyfishtë të zbatuar nga DDD, një standard vlerësimi për subjektin ■■■■■ dhe një standard tjetër, ndaj gjithë subjekteve të tjera që operojnë në këtë treg, për të cilat edhe pse janë me çmim transaksioni më lartë se subjekti ■■■■■ me dokumentacion shoqëruar të praktikës doganore të njëjtë, në të gjitha rastet nga DDDurrës, është zbatuar metoda e vlerësimit sipas të dhënave të disponueshme, duke ndërhyrë në elementët e vlerës.

- *Përfundimi është bërë vetëm për subjektin ■■■■■.*
- Ky favorizim për subjektin ■■■■■ i konstatuar në auditimin e periudhës 2012-2013-2014, vazhdon të aplikohet ende, duke favorizuar këtë subjekt në mënyrë permanente dhe duke vepruar në kundërshtim të plotë me KD, DZ dhe udhëzimin nr. 25, datë 30.11.2007.

## **10. DREJTORIA E TË ARDHURAVE, BASHKIA LEZHË**

Mbi auditimin me objekt: “**Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare për periudhën 01.01.2013-30.06.2014**” zhvilluar në nga data 20.10.2014 deri më 14.11.2014 dhe finalizuar me Vendimin Nr. 177 datë 23.12.2014 të Kryetarit të KLSH-së. Rekomandimet dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit u përcollën në subjekt me shkresën nr. 965/7, datë 23.12.2014.

Bashkisë Lezhë, *i është rikërkuar* zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar shkresën nr. 965/7, datë 23.12.2014, protokolluar në Bashkinë Lezhë me nr. 7415, datë 26.12.2014, mbi auditimin me objekt “**Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare**” të ushtruar në Drejtorinë e të Ardhurave, Bashkia Lezhë, të cilat nga auditimi i kryer kanë rezultuar të pa zbatuara apo të zbatuara pjesërisht si më poshtë:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

Janë lënë 5 rekomandime “Masa organizative”, për të cilat nga Bashkia Lezhë, rezultojnë të zbatuara 3 masa dhe në proces 2 masa.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 131-140 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve:*

**A.3.** Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Lezhë të propozojë dhe të kërkojë në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak, që të caktohen detyra konkrete dhe të ndërmerren hapa ligjor për nënshkrimin e marrëveshjeve të përbashkëta me agjentët tatimor si; ZVRPP; DRSHTRR; ALUIZNI dhe DRT Lezhë, apo me agjentët tatimor lokal si; KESH dhe UKL, duke shtuar një kapitull me sanksione përkatëse, për secilën palë, duke siguruar rritjen e efektivitetit të zbatimit të ligjit në realizimin e të ardhurave të programuara, me qëllim arkëtimi të jetë më i garantuar.

*Menjëherë*

**A.5.** Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Bashkia Lezhë të marrin masa për njoftimet e detyrimeve të pa likuiduara (borxh) gjendje deri në datën 30.06.2014, sipas evidencës; nga 133 subjekte biznes i madh në vlerën 7,529,660 lekë, nga 208 subjekte biznes i vogël në vlerën 3,877,288 lekë dhe nga 13,673 subjektet familjare për dy vitet për taksën dhe tarifën familjare në vlerën 40,004,909 lekë, në total të detyrimeve të pa likuiduara në vlerën 51,411,858 lekë, detyrime debitor gjendje në datë 30.06.2014, të cilat detyrimisht duhet të evidentohen në pasqyrat financiare të bilancit të Institucionit.

*Menjëherë*

### **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Nga KLSH, janë lënë 3 rekomandime “Masa për shpërblim dëmi”, në vlerën 3,925,958 lekë, për të cilat nga Bashkia Lezhë, për 22 tatimpagues, janë arkëtuar 289,199 lekë. Rezultojnë të pazbatuara 3 masa për 247 raste (tatimpagues) me vlerë 3,636,759 lekë.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 131-140 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve:*

**B.1.** Arkëtimin e vlerës prej 1,368,339 lekë të pa arkëtuar, nga subjektet të pa regjistruar, për 102 raste/subjekte, përlllogaritur dhe pa arkëtuar detyrimet e lindura nga aplikimi i nivelit të taksave e tarifave për vitin 2013 e pasqyruar në aneksi nr.1 bashkëlidhur me Reportin Përfundimtar të Auditimit të dërguar shkresën nr. 965/7, datë 23.12.2014.

*Menjëherë*

**B.2.** Arkëtimin e vlerës prej 1,090,820 lekë, nga subjektet të pa regjistruar, për 65 raste/subjekte, përllogaritur dhe pa arkëtuar detyrimet e lindura nga aplikimi i nivelit të taksave e tarifave për vitin 2014 e pasqyruar në aneksi nr.2 bashkëlidhur me Raportin Përfundimtar të Auditimit të dërguar shkresën nr. 965/7, datë 23.12.2014.

*Menjëherë*

**B.3.** Arkëtimin e vlerës prej 1,177,600 lekë, nga subjektet të pa regjistruar, për 80 raste/subjekte, përllogaritur dhe pa arkëtuar detyrimet e lindura nga aplikimi i nivelit të taksave e tarifave për vitin 2014 të mbartur nga subjektet që janë të pa regjistruar nga viti 2013 e pasqyruar në aneksi nr.3 bashkëlidhur me Raportin Përfundimtar të Auditimit.

*Menjëherë*

## **C. MASA DISIPLINORE**

Janë lënë 4 rekomandime “Masa disiplinore”, për të cilat nga Bashkia Lezhë, rezultojnë të pa zbatuara.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 131-140 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve:*

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, *i rikërkojmë* Kryetarit të Bashkisë Lezhë zbatimin e rekomandimeve. Të fillojnë procedurat për të kaluar në Komisionin Disiplinor, sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 për shkeljet e konsideruara nga ana jonë si shkelje të rënda dhe shumë të rënda, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013.

*-Neni 58, germa “c”, “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” për 4 nëpunës.*

## **11. DREJTORIA RAJONALE TATIMORE, ELBASAN**

Mbi auditimin me objekt: **“Mbi zbatimin e legjislacionit tatimor në procesin e realizimit të të ardhurave tatimore dhe vlerësimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm për vitet 2013, 2014”** zhvilluar në periudhën nga data 10.03.2015 deri më 21.05.2015 dhe finalizuar me Vendimin Nr. 60, datë 30.06.2015 të Kryetarit të KLSH-së. Rekomandimet dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit u përcollën në subjekt me shkresën nr. 179/25 prot, datë 04.07.2015.

*-Nga DRTE, nuk është zbatuar detyrimi ligjor prej 20 ditë mbi kthimin e përgjigjes KLSH për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.*

*-Nga DRTE, është kryer monitorimi i realizimit të Plan-veprimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar shkresën nr. 179/25 prot, datë 04.07.2015 dhe është njoftuar KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, me shkresën nr. 1478/108, date 30.12.2015, brenda afatit 6 mujor përcaktuar në nenin 30, pika 2 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.*

Nga DRT Elbasan me shkresën nr. 119, datë 27.11.2015 i është kërkuar Drejtorisë së Kontrollit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për të vendosur në programin e kontrollit subjektet e rekomanduara nga KLSH (masat “shpërblim demi” C.1 dhe C.3). Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk i është kthyer përgjigje në lidhje me këtë shkresë.

DPT dhe DRTE, *i është rikërkuar* zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr. 179/25 prot, datë 04.07.2015, mbi auditimin me objekt “**Mbi zbatimin e legjislacionit tatimor në procesin e realizimit të të ardhurave tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe vlerësimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm**”, për periudhën 2013-2014, të cilat nga auditimi i kryer për zbatimin e rekomandimeve, kanë rezultuar të pazbatuara apo në proces.

## **B. MASA PËR SHPËRBILM DËMI**

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 141-151 të RPA i rikërkohet zbatimin e rekomandimeve:*

**C.1.** Për 38 raste (subjekte), të mos vendosjen e penalteteve në shumën 107,401,347 lekë, sipas aneksit nr. 3, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të dërguar me shkresën nr 179/25 prot, datë 04.07.2015, pasi nga inspektorët e kontrollit operacional është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”.

*Menjëherë*

**C.3.** Për 9 raste (subjekte), të mos vendosjen e penalteteve në shumën 4,897,014 lekë, sipas aneksit nr. 2, bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, të dërguar me shkresën nr 179/25 prot, datë 04.07.2015, pasi nga inspektorët e kontrollit operacional është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”.

*Menjëherë*

## **12. DREJTORIA RAJONALE TATIMORE, BERAT**

Mbi auditimin me objekt: “**Mbi zbatimin e legjislacionit tatimor në procesin e realizimit të të ardhurave tatimore dhe vlerësimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm për vitet 2013, 2014**” zhvilluar në periudhën nga data 10.03.2015 deri më 22.05.2015 dhe finalizuar me Vendimin Nr. 61, datë 30.06.2015 të Kryetarit të KLSH-së. Rekomandimet dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit u përcollën në subjekt me shkresën nr.180/15 port datë 06.07.2015.

-Nga DRTBerat, nuk është zbatuar detyrimi ligjor prej 20 ditë mbi kthimin e përgjigjes KLSH për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Me shkresën nr. 911/217, datë 05.12.2015, nga ana e DRT Berat është hartuar plan veprimi me afat deri në 31.12.2015 i miratuar nga Drejtori Rajonal, për realizimin e rekomandimeve që janë në proces zbatimi dhe është njoftuar KLSH, për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

DRTBerat, *i rikërkohet* zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar me shkresën nr.180/15 port datë 06.07.2015, mbi auditimin e kryer me objekt “**Mbi zbatimin e Legjislacionit Tatimor në procesin e realizimit të të Ardhurave Tatimore, Kontributet e Sigurimeve Shoqërore si dhe Vlerësimi i funksionimit të Kontrollit të Brendshëm, Auditimin e Ligjshmërisë dhe Rregullshmërisë Financiare**”, të cilat nga auditimi kanë rezultuar të pa zbatuara, si më poshtë:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

Nga 10 masa organizative të rekomanduara, 1(një) masë rezulton e zbatuar dhe janë në proces zbatimi 9 masa.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 152-162 të RPA i është rikërkuar zbatimin e rekomandimeve:*



**A.1.** DRT Berat, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në lidhje me zërin “*Kapitali aksioner*” të deklaruar nga subjektet për të gjitha rastet që rezultojnë shumë herë më të vogla se “*Aktivet Afatgjata*”, të bëjë Kapitalizimin nga ortakët i kontributit të tyre, duke nxjerrë përgjegjësitë dhe personat përgjegjës me qëllim që të mos përsëritet fenomeni në të ardhmen.

*Menjëherë*

**A.2.** DRT Berat, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në lidhje me zhbllokimet e llogarive të subjekteve debitorë të nxjerrë përgjegjësitë dhe personat përgjegjës me qëllim që të mos përsëritet fenomeni në të ardhmen.

*Menjëherë*

**A.3.** Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, të marrë masa të plota lidhur me organizimin dhe funksionimin bashkëpunues midis Drejtorive dhe Sektorëve në përbërje të saj, me qëllim rritjen e nivelit të të ardhurave nga çdo tatim dhe taksë e programuar, nëpërmjet realizimit eficient të detyrave nga secili punonjës i stafit.

*Menjëherë*

**A.4.** Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, të mos pranojë asnjë pasqyrë financiare të paraqitur nga subjektet tatimpagues, pa një kontroll të plotë formal të saktësuar në një procesverbal unik, ku të regjistrohen të gjitha mangësitë e konstatuara nga verifikim i kryer nga inspektori i vlerësimit.

*Menjëherë*

**A.5.** Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, të marrë masa konkrete për të saktësuar nëpërmjet Sektorit të Verifikimit në Terren të gjithë subjektet që kryejnë aktivitetin e tyre ekonomik në ambiente apo godina të kontraktuara me qira, një kopje e së cilës duhet të administrohet në mënyrë të detyrueshme nga Sektori i Vlerësimit Tatimor.

*Menjëherë*

**A.6.** Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, me grupe pune të posaçme të analizojë nga zyra në mënyrë formale sipas një programi pune të veçantë të miratuar, ato subjekte tatimpaguese që rezultojnë me teprica kreditore apo me humbje, të cilat më pas të kalojnë për kontroll të plotë të thelluar nga Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit në Drejtorinë e Kontrollit të Tatimor.

*Menjëherë*

**A.7.** Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të marrë masa konkrete për të përgatitur Regjistra Rimbursimi (unik), për regjistrimin e kërkesave të paraqitura nga subjektet tatimpaguese për rimbursimin e tepricës kreditore të TVSH-së.

*Menjëherë*

**A.8.** Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, të marrë masa të plota në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Zyrën e Përmbarimit Gjyqësor, në mënyrë që të zbatohen nëkohë dhe me efektivitet masat shtrënguese për arkëtimin e borxhit tatimor të pa paguar.

*Menjëherë*

**A.9.** Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për arritjen e një vlerësimi të saktë të ngjarjeve ekonomike në këtë kompani, të marrë masa të plota për të kryer një ri kontroll i plotë në këtë subjekt për periudhën në fjalë.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR SHPËRBILM DËMI**

Janë rekomanduar 6 (gjashtë) masa “Shpërblim dëmi”, në vlerën 63,601,460 lekë, të cilat nuk janë zbatuar.

Sa më sipër, trajtuar në faqet 152-162 të RPA i është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve:

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandojmë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat, marrjen në shqyrtim të këtyre gjetjeve të konstatuara në lidhje me detyrimet tatimore të pa përllogaritura dhe të pakontabilizuara, të cilat në total janë në vlerën 63,601,460 lekë, për praktikat e mëposhtme:

**B.1.** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë dhe Fier, të marrë në shqyrtim gjetjet e konstatuara në lidhje me detyrimet tatimore të pakontabilizuara, për 39 raste, në vlerën 3,600,000 lekë, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë në lidhje me personat përgjegjës sipas aneksit nr. 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit të dërguar me shkresën nr.180/15 port datë 06.07.2015.

*Menjëherë*

**B.2.** Nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat të merren në shqyrtim gjetjet e konstatuara në lidhje me detyrimet tatimore të pa përllogaritura dhe të pakontabilizuara, të cilat në total janë në vlerën 60,001,460 lekë në mënyrë analitike si më poshtë:

**B.2.1.** Drejtoria Rajonale Tatimore të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 43 raste, në vlerën 45,142,131 lekë nga subjektet sipas aneksit nr. 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit të dërguar me shkresën nr.180/15 port datë 06.07.2015.

*Menjëherë*

**B.2.2.** Drejtoria Rajonale Tatimore Berat të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 805 raste, në vlerën 8,523,173 lekë nga subjektet sipas aneksit nr. 1; nr. 2; nr. 3; nr. 4; nr. 5; nr. 6 dhe nr.7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit të dërguar me shkresën nr.180/15 port datë 06.07.2015.

*Menjëherë*

**B.2.3.** Drejtoria Rajonale Tatimore të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 39 raste, në vlerën 955,000 lekë nga subjektet sipas aneksit nr. 9 dhe nr.11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit të dërguar me shkresën nr.180/15 port datë 06.07.2015.

*Menjëherë*

**B.2.4.** Drejtoria Rajonale Tatimore Berat të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për 18 raste, në vlerën 5,131,156 lekë nga subjektet sipas aneksit nr. 15; nr. 16 dhe nr.17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit të dërguar me shkresën nr.180/15 port datë 06.07.2015.

*Menjëherë*

**B.2.5.** Drejtoria Rajonale Tatimore Berat të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit nga subjekti [REDACTED], në vlerën 250,000 lekë.

*Menjëherë*

### **13.NJËSIA E MBIKQYRJES SË LOJRAVE TË FATIT**

Mbi auditimin me objekt: “Mbi zbatimin e procedurave të liçencimit, mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së subjekteve, që organizojnë lojra fati, në territorin e RSH, nga NJMLF, në përputhje me legjislacionin për këtë veprimtari dhe aktet nënligjore në fuqi, për vitet 2013, 2014” zhvilluar në periudhën nga data 06.01.2015 deri më 23.02.2015 dhe finalizuar me Vendimin

Nr. 40, datë 31.03.2015 të Kryetarit të KLSH-së. Rekomandimet dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit u përcollën në subjekt me shkresën nr. 1207/7, datë 07.05.2015.

-Nga NJMLF, nuk është zbatuar detyrimi ligjor prej 20 ditë mbi kthimin e përgjigjes KLSH për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga DRTE, është kryer monitorimi i realizimit të Plan-veprimit për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar shkresën nr. 1209/7, datë 25.03.2015 dhe është njoftuar KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, por duke tejkaluar afatin 6 mujor përcaktuar në nenin 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Njësisë së Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit, *i është rikërkuar* zbatimi i rekomandimeve të KLSH-së, të dërguar shkresën nr. 1207/7, datë 07.05.2015, mbi auditimin me objekt “Mbi zbatimin e procedurave të liçencimit, mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së subjekteve, që organizojnë lojra fati, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nga Njësia e Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit (NJMLF), në përputhje me legjislacionin për këtë veprimtari dhe aktet nënligjore në fuqi” të cilat nga auditimi i kryer për zbatimin e rekomandimeve, kanë rezultuar të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht, apo në proces si më poshtë:

#### **A. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIME LIGJORE:**

Nga KLSH, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit janë lënë 6 rekomandime “Për përmirësime ligjore”, për të cilat nga NJMLF, janë hartuar shkresat për Institucionet përkatëse. Ky rekomandim konsiderohet i realizuar.

#### **B. MASA ORGANIZATIVE**

Nga KLSH, sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit janë lënë 13 rekomandime “Masa organizative”, për të cilat nga NJMLF, rezultojnë të zbatuara 10 masa, në proces 2 masa dhe e pazbatuar 1 masë.

*Sa më sipër, trajtuar në faqet 163-168 të RPA rikërkojmë zbatimin e rekomandimeve:*

**B.11.** Të merren masa që nga grupet e kontrollit në akt konstatimet e mbajtura në subjekte, në rastet e konstatimit të ushtrimit të veprimtarisë pa leje, gjetjes së mjeteve të pa licencuara, të përshkruhet numri, tipi dhe numrat serial të tyre.

Mënyra e plotësimit të akt konstatimeve për këto raste të përcaktohet në Rregulloren e brendshme të NJMLF-së, neni 35 “Kontrolli në subjekte”.

*Menjëherë*

**B.12.** Nga titullari i NJMLF, në cilësinë e nëpunësit autorizues të merren masa të menjëhershme, për implementimin e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Manualin për MFK-në, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij.

*Menjëherë*

**B.13.** Nga NJMLF të merren masa të menjëhershme, për ngritjen e një komisioni i cili të marrë në shqyrtim dhe të vendosë gjobat në zbatim të ligjit nr. 10033 datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit” me ndryshime, neni 47 “Kundërvajtjet administrative” për të gjitha rastet e përcaktuara, në vlerën totale 143,500,000 lekë.

*Menjëherë*

#### **14. DEGA DOGANORE, ELBASAN**

Mbi auditimin me objekt: “**Mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare për vitin 2013**” zhvilluar në periudhën nga data 02.10.2014 deri më 07.11.2014 dhe finalizuar me Vendimin Nr.193, datë 31.12.2014 të Kryetarit të KLSH-së. Rekomandimet dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit u përcollën në subjekt me shkresën nr. 940/7, datë 07.01.2015.

-Nga DD Elbasan, është zbatuar detyrimi ligjor prej 20 ditë mbi kthimin e përgjigjes KLSH për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, përcaktuar në nenin 15 germa (j) të ligjit nr. 154/214, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga DD Elbasan, është kryer monitorimi i realizimit të Plan-veprimit dhe është njoftuar KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dërguar me shkresën nr. 940/7, datë 07.01.2015.

-Kryetari i Degës ka nxjerrë urdhrin e brendshëm nr. 29, datë 19.01.2015 për zbatimin e rekomandimeve dhe janë realizuar 100% të gjitha rekomandimet e KLSH.

*Sa me lart subjektit Dega e Doganës Elbasan, nuk ju rikërkua zbatimi i masave.*

#### **15. BASHKIA VLORË, DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE.**

Mbi auditimin me objekt: “**Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare për periudhën 01.01.2012-30.09.2014**” zhvilluar nga data 03.09.2014 deri më 15.10.2014 dhe finalizuar me Vendimin Nr. 174, datë 23.12.2014 të Kryetarit të KLSH-së. Rekomandimet dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit u përcollën në subjekt me shkresën nr. 836/7 port. datë 23.12.2014.

- Bashkia Vlorë nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 20 ditësh, përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, për të informuar për fillimin e procedurave të zbatimit të rekomandimeve.

- Nga Bashkia Vlorë është hartuar Plan-Veprimi për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së dërguar me shkresën nr. 5516/1 port. datë 21.01.2015.

-Nga 7 Masa Organizative të rekomanduara janë zbatuar plotësisht 3 dhe janë në proces zbatimi 4 masa. Masa për shpërblim dëmi, në vlerën 165,110 lekë, është zbatuar plotësisht.

Masa disiplinore, e rekomanduar, quhet e ezauruar pasi Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Vlorë është ristrukturuar.

*Sa me lart, subjektit Bashkia Vlorë, nuk ju rikërkua zbatimi i masave.*

#### **16. DEGA DOGANORE TRE URAT, PËRMET**

Mbi auditimin me objekt: “Mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë financiare për periudhën 01.01.2013 deri 30.06. 2014” zhvilluar nga data 13.10.2014 deri më 11.11.2014 dhe finalizuar me Vendimin Nr.199, datë 31.12.2014 të Kryetarit të KLSH-së. Rekomandimet dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit u përcollën në subjekt me shkresën nr. 963/7, date 06.01.2015.

- Dega e Doganës Tre Urat, Përmet, ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 20 ditësh, përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

- Nga Dega e Doganës Tre Urat, Përmet është hartuar Plan-Veprimi nr. 110, datë 10.02.2015 për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së dërguar me shkresën nr. 963/7, date 06.01.2015.

-Nga 5 Masa Organizative të rekomanduara janë zbatuar 5, ose 100%. Nga 8 masa zhdëmtim dëmi në vlerën 6,375,123 lekë, janë zbatuar plotësisht 8 ose 100%. Për 1 masë administrative të rekomanduar

rezulton e realizuar pjesërisht. Nga 5 masa disiplinore të rekomanduara janë zbatuar 5 masa, ose 100%.

*Sa me lart, subjektit Dega e Doganës Tre Urat, Përmet, nuk ju rikërkuar zbatimi i masave.*

**Shënim:**

1. Në bazë të Udhëzimit të Kryetarit nr. 3, datë 3.11.2015 “Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH”, pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, do të përcillen në subjektet përkatëse të shoqëruar me shkresën për rikërkim të rekomandimeve të pazbatuara, si dhe për DPD dhe DPT do të përcillen edhe të gjitha pjesët e Raportit Përfundimtar të Auditimit të degëve dhe drejtorive të vartësisë, përgjatë muajit janar 2016.

2. Përmbledhje e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Vendimi, do të përcillet Komisionit të Ekonomisë dhe Kryeministrit përgjatë muajit janar 2016, me synimin informimin për zbatimin e rekomandimeve tona dhe zbatimin e ligjit të KLSH nga Institucionet.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 186, datë 31.12.2015, është ngarkuar Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

**Shënim:** Auditimi u krye përgjatë periudhës 05.11.2015 deri më 11.12.2015, nga audituesit shtetëror: Vullnet Karafilaj, Agron Opari, Livan Hoxha, Edvin Stefani, Anesti Gjika, Artan Mirashi, Aqif Klosi, Hekuran Avdulaj, Brunilda Zeneli, Vladimir Rizvani, Dorino Meçe, Joniada Goçaj, Elida Koçani, Altin Dinaj, u mbikëqyr nga Drejtori i Departamentit zj. Albana Agolli, u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, z. Ermal Yzeiraj dhe Drejtori i Përgjithshëm zj. Manjola Naço.

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT**